



PHD SAIMIR SHTYLLA

Lektor

Departamentin e Arkitekturës
dhe Dizajnit

KONTAKTE

✉ s.shtylla@umb.edu.al



PHD SAIMIR SHTYLLA

Lektor

Departamentin e Arkitekturës
dhe Dizajnit

BIOGRAFIA

Pedagog në Departamentin e Arkitekturës dhe Dizajnit në Universitetin Barleti, Saimir Shtylla diplomohet në vitin 2013 në Departamentin e Arkitekturës në Universitetin e Ferrarës në Itali dhe në 2020 përfundon doktoraturën në Programin Ndërkombëtar të Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban - IDAUP me fokus shndërrimin e tyre në godina me energji afër zero të tipologjive të ndërtesave arsimore ekzistuese në Shqipëri nëpërmjet dy skenarëve të mundshëm. Gjatë studimeve doktorale, ai ka marrë pjesë në programin bilateral në fushën e kërkimit shkencor midis Universitetit Polis dhe ITC-CNR (Itali) me fokus studimin, eksperimentimin e materialeve dhe teknologjive për mekanizimin e energjisë si dhe karakteristikave të godinave me qëllim transformimin e tyre në godina me energji afër zero. Aktiviteti i tij didaktik përqendrohet në fushat e projektimit arkitektonik, rikuperimit të trashëgimisë arkitektonike dhe arkeologjike si dhe teknikave të paraqitjes arkitektonike nëpërmjet programeve të projektimit të metodologjisë Building Information Modelling (BIM). Pjesëmarrës në konferenca dhe ndërkombëtare me tematika të lidhura me çështjet e urbanistikës dhe projektimit të qëndrueshëm, ai është recensues shkencor për botime mbi qëndrueshmërinë arkitektonike, industrinë kreative dhe për Civil Engineering and Architecture Journal. Ai është bashkautor i botimeve ndërkombëtare me fokus risitë në fushën e arkitekturës, urbanistikës dhe industrive Kreative si “Designing Futures. Bridging Creativity, Sustainability, and Technology in Education and Industry” dhe “Approaching Regeneration of the Built Environment. Between Research, Innovation and Challenges” për Advances in Science, Technology & Innovation (ASTI) Book series. Nga viti 2015, ai është arkitekt i licencuar dhe ka marrë pjesë në shumë projekte arkitektonike dhe urbanistike në Shqipëri ku prej disa vitesh aplikon metodologjinë BIM. Pjesëmarrës në konkurse të ndryshme ndërkombëtare, ku është vlerësuar me çmimin e parë në konkursin ndërkufitar për profesionistët e rinj Kosovë - Shqipëri në 2016, si pjesëtar dhe drejtues grupi projektimi të përbërë nga arkitektë dhe urbanistë shqiptarë dhe të huaj e finalizuar me dokumentin final për zhvillimin e zonës ndërkufitare të midis Shqipërisë dhe Kosovës në bashkëpunim me ministritë përkatëse.